

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“REGINA MARIS - VOYAGER” sh.p.k

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e shoqërisë

Neni 1
Data e themelimit, Emri dhe Themeluesi

Shoqëria “**REGINA MARIS - VOYAGER**” sh.p.k themelohet në Tiranë me datë 01.09.2025 nga themeluesi:

- **Eno SEFERI**, datëlindja 14.04.1984 lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal I40414072V.

Neni 2
Organizimi

Shoqëria “**REGINA MARIS - VOYAGER**” do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 3
Kohëzgjatja

Shoqëria “**REGINA MARIS - VOYAGER**” sh.p.k. është krijuar për të ushtruar veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar kohe.

Veprimtaria e shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar dhe kjo veprimtari do të vazhdojë të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe çdo ndryshim qe do të bëjë shoqëria do të reflektohet në aktet e shoqërisë.



Neni 4

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative Farkë, Rruga "Ullishta", Pallati Primavera, Kati 0, Zona Kadastrale 3266, Nr. Pasurie 96/64-N2, Tiranë.

Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Shërbime në fushën e udhëtimeve detare ndërkombëtare dhe kryesisht në shitjen e biletave të udhëtimit për tragete. Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të hapë njësi shërbimi e tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizikë e juridikë, vendas e të huaj. Prerja e siguracioneve e mjeteve detare dhe të udhëtarëve. Transport detar ndërkombëtar të udhëtarëve. Organizim të trajnimeve dhe programeve edukuese në industrinë e transportit detar. Organizim të mbledhjeve, incentivave, konferencave dhe evenimenteve kulturore (MICE). Përfaqësues në territorin e Shqipërisë të kompanive të trageteve. Shitje bileta online. Organizim i udhëtimeve detare me mjete të të tretëve apo të vetë shoqërisë. Agjenci detare dhe spedicionere, furnizim anijesh me materiale të ndryshme konsumi, karburante lubrifikante si dhe të gjitha paisjeve të nevojshme për kryerjen e procesit teknologjik. Transportim dhe tregtimi me shumice e pakice për import eksport të mallrave të ndryshme industriale. Transportim dhe tregtim me shumice e pakice për import-eksport të kimikateve të ndryshme, etj. Ndertimi sipas funksioneve të të gjitha llojeve dhe dimensioneve të mjeteve lundruese. Të transportojë mallra, mjete, personel, turiste dhe persona me mjete lundruese. Të marrë në përdorim, të tregtojë, të lëshojë me qira të gjitha llojet e mjeteve lundruese detare qofshin ato motorrike apo jo. Operator turistik. Operator turistik detar. Transport i udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit. Aktivitet në fushën e sporteve ujore. Agjenci detare etj. Hapjen e agjencive turistike, doganore, detare, spedicionere, ormexhim, pilotim, heqje plehra nga mjetet lundruese e të gjitha llojeve, trageti transportin e pasagjereve dhe të mallrave me automjete në anije. Agjent siguracionesh dhe nenkontraktor i shërbimeve të udhëtimeve detare. Agjenci detare për të ofruar shërbim të panderprere dhe profesional operatorëve të ndryshëm pronarë të të gjitha llojeve, dimensioneve dhe funksioneve të mjeteve



lundruese, çarterues, menaxher dhe tregëtarë që aktualisht kryejnë aktivitetet e tyre nëpërmjet porteve detare shqiptare. Trajnimi i këtij shërbimi sipas praktikave standarte ndërkombëtare, në administrimin e praktikave detare, duke garantuar shërbim të specializuar, profesional dhe të shpejtë. Shërbim ndaj klienteve e bagazheve, mjeteve të çdo lloji, detare dhe ato të transportit. Transport i mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashtë vendit, për llogari të shoqërisë dhe të të tregëtarëve, me mjetet e vetë shoqërisë ose me mjetet e të tregëtarëve. Transport detar, ajror, tokësor. Të prejë dhe të përcjellë anije të çdo shoqërie deri në largimin e tyre nga Kalatat detare. Të pajisë anijet e lundrimit të çdo shoqërie me listën e emrave dhe kopjen e biletave. Agjencia ka të drejtë të lidhë çdo marrëveshje me agjenci të tjera brenda dhe jashtë vendit për bashkëpunim me të në fushën ku ushtron këtë veprimtari për t'ju ofruar shërbim të përpunues dhe profesional operatorëve të ndryshëm si: pronarë anijesh, çarterues, menaxher dhe tregëtarë që aktualisht kryejnë aktivitetet e tyre nëpërmjet porteve detare shqiptare dhe të huaja. Marrja me qera e të gjitha llojeve, dimensioneve dhe funksioneve të mjeteve lundruese, përpunimi i anijeve, furnizimi i tyre me karburantë, kryerja e shërbimeve portuale dhe ato të anijeve, transport të bagazheve, pasagjereve, mallrave, kontejnerëve, përpunimi i tyre në portet përkatëse. Kryerja e guidave turistike, të pasagjereve, transporti i tyre, dhenia me qera e mjeteve të transportit për turistët dhe pasagjereve që do operojë kjo agjenci. Shërbime portuale, Ormëxhim dhe Pilotim i mjeteve detare në port. Zhvillimin e panairëve, seminarëve dhe work-shopeve në fushën e turizmit. Autopsia-Inspektimi i certifikuar i të gjitha mjeteve detare. Certifikim, distributor, regjistrim, paisje i flamurëve dhe entiteteve. Shërbime doganore (check in – check out). Shërbime portuale: hyrje në port, furnizim me ujë, furnizim me karburant, pastrim mbetjesh, furnizim ushqimor. Operator turistik detar, shërbime turistike charter dhe daily. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj si dhe të gjitha veprimtaritë e parashikuara nga Kodi Detar Shqiptar, që lidhet me të dhe që e mbështet atë. Shoqëria ka të drejtë të hapë dhe operojë si: Agjenci për prerjen e sigurimeve dhe të gjitha produktet e agjencive të sigurimeve. Të marrë dhe të japë hua si dhe të marrë e të vendosë kolaterale nga: shoqëri, institucione financiare, banka, fondacione, individë brenda dhe jashtë vendit. Investime financiare të lejueshme nga ligji dhe të gjitha llojet e veprimtarive të real-estate. Shoqëria mund të kryejë edhe çdo veprimtari tjetër e cila është në ndihmë dhe e lidhur me objektin kryesor të veprimtarisë së saj. Shoqëria mund të financohet nga shoqëri private vëndase dhe të huaja. Administrim dhe ndërtim i të gjitha llojeve të parkingjeve. Kantier ndërtimi detar-Porto Romano. Kantier shërbimi dhe ndërtimi i mjeteve lundruese prej hekuri, alumini, druri dhe rezine. Shërbime dhe servise restaurimi, rikonstruktime dhe riparime, rezinë-punues, saldator, zdrëkthtari, kapanon i mbyllur si dhe parkim i hapur. Transport rrugor i të gjitha mjeteve lundruese me karrela të të gjitha përmasave. Përfaqësues në territorin e Shqipërisë e kompanive ndërkombëtare që operojnë në sektorin detar. Çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt me aktivitetet e lartpërmendura sipas parashikimeve të Lloyd's

Register Foundation. Shoqëria mund të kryejë edhe çdo aktivitet të parashikuar nga Legjislacioni Shqiptar.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në të holla i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, me vlerë 100,000 (njëqindmijë) LEKË. Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë:

Ortaku themelues Eno Seferi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100,000 (njëqindmijë) lekë, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 7 Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, e cila merr vendime në përputhje me nenin 81, pika 3 e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008.

Neni 8 Çertifikatat e kuotave

Ortakët kanë të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotat e zotëruara prej tyre, të cilat lëshohen nga ana e shoqërisë. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave



Kuotat e kapitalit të shoqërise dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me vendim, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga ana e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë sipas nenit 81 pika 3 te Ligjit 9901.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e asamblese së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë sipas nenit 81 pika 3 te Ligjit 9901.

Neni 11

Blerja e Kuotave të Veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare".

Neni 12

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar



Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Neni 13

Shpërndarja e fitimit

Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e nenit 8/1, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

Neni 14

Ushtrimi i veprimtarisë

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë realizohet në bazë të dobisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë duhet të përfundojë dhe të jetë i miratuar brenda muajit mars të vitit pasardhës. Bilancet e shoqërisë mund të bëhen nga vetë shoqëria ose nga ekspertë të caktuar dhe kontraktuar prej saj.

Shoqëria krijon fondet e saj, përveç krijimit të fondeve të detyruara sipas ligjit, të cilat do të përdoren për zhvillimin e zgjerimin e veprimtarisë saj sipas rregullave në fuqi. Përbërja e këtyre fondeve caktohet me vendim të asamblese së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë sipas nenit 81, pika 3 të Ligjit 9901.

Shoqëria është pronare e mjeteve të saj financiare dhe i disponon vetë ato.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 15



Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
Administratori

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që ka për kompetencë ndryshimin e statutit të shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore.

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;



i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortakët konform nenit 81, pika 3 te Ligjit 9901.

Neni 17

Marrja e vendimeve

Te gjitha te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortakët. Te gjitha vendimet regjistrohen ne nje regjister te vendimeve. Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- Shperndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- Investime;
- Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

Neni 18

Emërimi i Administratorit

Administrator i shoqërisë i emëruar nga mbledhja themeluese është:

Eno Seferi, atësia Valter, i datëlindjes 14.04.1984, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal I40414072V.

Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit fillon të prodhojë efekte pas regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Mandati i administratorit fillon me datë 01.09.2025 dhe mbaron me datë 01.09.2030.

Neni 19

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë si dhe detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 20

Perfaqësimi

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 21

Shpërblimi dhe Përfitimet e tjera të Administratorit

Administratori shpërblehet në bazë të Vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 22

Kufizimet e Administratorit

Administratori i shoqërisë, në ushtrimin e veprimtarisë së tij mban parasysht kufizimet që rrjedhin nga neni 13 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Ai në asnjë

rast nuk lejohet të lidhë kontrata huaje dhe garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë.

Në rastet kur ai vepron në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 dhe nenit 14/5 të statutit është vetë subjekt i dënimeve të parashikuara në nenin 13, pika 7 e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe përgjigjet vetë në mënyrë solidare e shoqërinë me të gjithë pasurinë tij sipas parashikimeve të nenit 16 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 23

Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mos veprimi është kryer në mirëbesim.

Neni 24

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri

Marrëdhëniet e punës me punonjësit që do të punësohen pranë shoqërisë rregullohen me kontratën e punës individuale që do të lidhet me secilin prej tyre.

KREU IV

VITI FINANCIAR- EKSPTERTËT

Neni 25

Viti financiar i shoqërisë fillon me datë 1 Janar të cdo viti dhe mbaron me datë 31 Dhjetor të cdo viti.

Neni 26

Eksptertët

Ekspterti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë të në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar me një gjë të tillë nga ana e asamblese se pergjithshme te ortakeve te shoqërisë.



Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i certifikuar paraqet me shkrim raportin për nxjerrjen e rezultatit financiar të bilancit vjetor, si dhe për atë të kontrolleve periodike të kryera prej tij, të cilat është i detyruar t'i dprëzjë në kohë për tu shqyrtuar nga ana e asamblese se pergjithshme te ortakeve të shoqërisë.

KREU V

PRISHJA LIKUIDIMI

Neni 27

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria “REGINA MARIS - VOYAGER” sh.p.k prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblese se pergjithshme
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 28

Shndërimi i shoqërisë

Asambleja e pergjithshme, ka të drejtë që me vendim të vendosë për shndërrimin, transformimin e shoqërisë në ndonjë formë tjetër të shoqërive tregtare, duke zbatuar rregullat në fuqi.

Neni 29

Riorganizimi shoqërisë



Shoqëria mund të ndahet të bashkohet me vendim të asamblese se pergjithshme te ortakeve. Ky proces do të bëhet në përuthje me rregullat e parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 30
Baza ligjore

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi.

Për aq sa nuk parashikohet në këtë Statut do të zbatohen parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe të çdo ligji tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU

ENO SEFERI

